



<https://differentandequal.org/en/>

2023

**Raport Vjetor
Organizata "Të
Ndryshëm & të
Barabartë"**



**DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & TE BARABARTE**

1

Projektet e zbatuara gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023

2

Përfituesit e programit

3

Aktivitete/shërbime/programe të realizuara

- 3.1. Shërbime direkte riintegruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit
- 3.2. Identifikimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet Njësive Lëvizëse
- 3.3. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për çështje të trafikimit, dhunës dhe abuzimit
- 3.4. Ofrimi i shërbimeve alternative (paradite dhe mbasdite) të përkujdesjes së fëmijëve, për fëmijët e nënave që janë duke rindërtuar jetën e tyre
- 3.5. Rritja e kapaciteteve për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit dhe individë të tjerë vulnerabël nëpërmjet fuqizimit të profesionistëve të ligjit dhe avokatisë “probono”
- 3.6. Konsolidimi i Sistemeve për Fuqizimin e Viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@Sh)
- 3.7. Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit
- 3.8. Fuqizojmë Komunitetin në Bashkinë Lezhë
- 3.9. Paketa e Avokimit të të mbijetuarve për përmirësimin e përgjigjes së drejtësisë penale ndaj viktimave të reja të dhunës seksuale në Shqipëri
- 3.10. Fuqizimi i stafit i cili punon me viktimat e trafikimit për të parandaluar traumën sekondare dhe konsumimin profesional

4

Koordinime me aktorë të tjerë antitrafikim

5

Pjesëmarrja e stafit në trajnime

6

Manuale, Udhëzues dhe materiale të tjera - Botime

1 Projektet e zbatuara gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023

Projekti 1: “Identifikimi, referimi dhe ofrimi i shërbimeve cilësore për mbështetjen dhe riintegrimin e të mbijetuarve të trafikimit në njerëz në Shqipëri”

Donator: UNICEF me fonde të Ambasadës Britanike

Kohëzgjatja: 1 Janar 2023 - 31 Mars 2024

Projekti 2: “Konsolidimi i Sistemeve për Fuqizimin e Viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@Sh)”

Donator: Bashkimi Evropian në kuadër të programit “Mbështetja e BE-së për Përfshirjen Sociale në Shqipëri”

Kohëzgjatja: Maj 2022 - Prill 2025

Projekti 3: “Programi i riintegrit për emigrantët e kthyer në Shqipëri”

Donator: GIZ

Kohëzgjatja: Dhjetor 2020 - Qershor 2023

Projekti 4: “Rritja e kapaciteteve për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit dhe individë të tjerë vulnerabël nëpërmjet fuqizimit të profesionistëve të ligjit dhe avokatisë ‘probono’”

Donator: UNDP

Kohëzgjatja: Dhjetor 2022 - Nëntor 2023

Projekti 5: “Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit”

Donator: Agjensia Kombëtare e Rinisë (AKR) / Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Kohëzgjatja: Dhjetor 2022 - Gusht 2023

Projekti 6: “Ofrimi i programeve të riintegrit ekonomik për të paktën 80 gra në bashkitë e Kukësit, Dibërës, Korçës dhe Beratit, përfshirë edhe gratë e grupeve vulnerabël”

Donator: UN Women në kuadër të programit “Fund dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi Faza II”, financuar nga Bashkimi Evropian

Kohëzgjatja:

Projekti 7: “Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse të riintegrit për viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe abuzimit seksual në Shqipëri”

Donator: Fondacioni ARISE /L’Oreal

Kohëzgjatja: Nentor 2022 - Nentor 2023

Projekti 8: “Ofrimi i shërbimeve të drejtpërdrejta për të mbështetur viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore”

Donator: Fondacioni ARISE

Kohëzgjatja: Janar 2022 - Qershor 2023

Projekti 9: “Fuqizojmë Komunitetin në Bashkinë Lezhë”

Donator: D&E po e zbaton në bashkëpunim me UNDP dhe Bashkinë Lezhë me mbështetjen financiare të USAID në Shqipëri

Kohëzgjatja: Tetor 2023 - Prill 2024

Projekti 10: “Ofrimi i programeve të riintegritit ekonomik për gratë e mbijetuara të dhunës, duke përfshirë gratë nga grupet vulnerabël në bashkitë e synuara në Shqipëri”

Donator: Në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Fund Dhunës ndaj Grave” Faza II e financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga UN Women, UNDP dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë Shqiptare

Kohëzgjatja: Tetor 2023 - Korrik 2025

Projekti 11: “Fuqizimi i stafit që punon me viktimat e trafikimit për të parandaluar traumën sekondare dhe konsumimin profesional”

Donator: Ambasada e SHBA në Tiranë, Shqipëri

Kohëzgjatja: Shtator 2023 - Gusht 2024

Projekti 12: “Shërbime gjithëpërfshirëse riintegrimi për viktimat e trafikimit, duke përfshirë nënat e vetme VeT dhe fëmijët e tyre”

Donator: World Vision

Kohëzgjatja: 5 months

Projekti 13: Të mësojmë së bashku

Donator: Universiteti Bedfordshire

Kohëzgjatja: Mars 2023 - 2024

Projekti 14: “Paketa e Avokimit të të mbijetuarve për përmirësimin e përgjigjes së drejtësisë penale ndaj viktimave të reja të dhunës seksuale në Shqipëri

Donator: New Venture Fund

Kohëzgjatja: 1 Shtator 2023 - 31 Maj 2024

2 Përfituesit e programit


Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 janë asistuar në total në programin riintegruar të organizatës 244 raste dhe 297 fëmijë të tyre.

- 125 raste të asistuar gjatë kësaj periudhe janë viktime/ viktime të mundshme trafikimi dhe 55 fëmijë të tyre.
- 119 raste janë viktime të abuzimit seksual dhe dhunës në familje dhe 242 fëmijë të tyre.

Kategoritë e përfitueseve të asistuar në program Janar - Dhjetor 2023:

Kategoria	Totali i rasteve të asistuar 2023	Rastet mbartura nga Dhjetor 2022	Rastet e reja në program 2023
Viktima trafikimi / Viktima të mundshme trafikimi	125	73	52
Fëmijë të rasteve VeT shoqëruar me nënat e tyre	55	26	29
Viktima të abuzimit seksual dhe dhunës në familje	119	61	58
Fëmijë të rasteve VDH shoqëruar me nënat e tyre	242	110	132
Totali	541	270	271

PROFILI I RASTEVE VIKTIMA / VIKTIMA TË MUNDSHME TRAFIKIMI




Menyra e rekrutimit	Nr i rasteve
Premtim për martesë	9
Premtim për punë	5
Shfrytëzim i situates vulnerabël	10
Ndikim nga grupi shoqëror për përfshirjen në situatë të rrezikshme për shfrytëzim	16
Shfrytëzuar nga i dashuri / bashkëjetuesi / bashkëshorti	6
Shfrytëzuar nga anëtarë të familjes	6
Totali	52



Forma e shfrytëzimit	Nr i rasteve
Shfrytëzim seksual	22
Punë e detyruar	4
Aktivitet kriminal (shpërndarje droge)	12
Shfrytëzim seksual/ shfrytëzim për punë	1
Shfrytëzim seksual/ Aktivitet kriminal	6
Lypje	7


Referimet e rasteve sipas muajve:



Burimi i referimit për rastet e reja të asistuara gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023:


Burimet e referimeve	Nr. i rasteve
Njësia Lëvizëse Tiranë , Shkodër	35
PMF 9	1
QKPVT	3
Streha LGBT	1
Global Care	1
Dimak / Giz	1
PMF Berat	3
Bashkia Kukës	1
PMF Bathore	1
Kisha - Institucion fetar	2
Shtëpia e fëmijës 16 - 18 - Shkodër	1
Kom nr.3 dhe PMF 10, PMF 4	2
TOTAL	52

PROFILI I RASTEVE VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE DHE ABUZIMIT



Referimet e rasteve sipas muajve:

58 raste viktimas të dhunës në familje dhe 132 fëmijë të tyre kanë hyrë në program gjatë kësaj periudhe.



Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023:

Burimet e referimit	Nr. i rasteve
Nga të tjerë	4
NLQ	1
Solwodi	2
Argitra	1
Bashkia Shkodër, Bashkia Has / Kukës	12
QKPVDHF	4
Njësia adm. Nr 1 / Nj. Adm. Nr 9 / PMF Dajt	3
World Vision	1
Psikologe e shkollës / Mesuese e shkollës	2
Streha "Edlira Haxhiymeri"	1
QKPVDH	5
Komisariati nr 8	1
IOM Albania	1
Kordinator dhune Kamëz/ Berat/ Njësia 7/Tiranë	8
Organizatë e Huaj	1
Sos fshatrat e fëmijëve	1
Giz	1
Vetreferuar	3
Papa Xhovani XXII	1
Mary Ward Loreto	1
Qendra shëndetsore Kashar	1
Lilium	1
Bashkia Librazhd	1
MU Tirana	1
TOTAL	58

3 Aktivitete/shërbime/programme të realizuara

3.1. Shërbime direkte riintegruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit

D&E ka ofruar asistencë riintegruese për viktimat e trafikimit në tre faza:

Faza #1: Ndërhyrja në situatë krize dhe Akomodimi

Faza #2: Faza tranzit e cila përfshin jetesën gjysëm të pavarur

Faza #3: Riintegrimi dhe përfshirja sociale

Një paketë e plotë shërbimesh riintegruese është ofruar për përfituesit e programit të riintegrit të D&E: Strehim, siguri dhe plan ri-integrimi; Asistencë e menjëhershme mjekësore; Negocim/ ndërmjetësim me familjen; Vlerësime dhe këshillime psikologjike; Mbështetje dhe asistencë ligjore; Asistencë për rregjistrim/vazhdimësinë e sistemit shkollor; Trajnime profesionale; Aktivitete sociale; Mentorim; Këshillim dhe ndihmë për punësim; Mbështetje financiare për strehim; Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/ harta e shërbimeve; Programe pune që krijojnë të ardhura; Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit; Monitorim dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve te programit.

Përveç asistencës direkte me përfitueset, D&E ka punuar e mbështetur dhe familjen eviktimave p.sh. fëmijët e përfitueses, asistencë për prindin e një minoreni që të gjejë punë, këshillim familjar etj.

Paketa e shërbimeve që është ofruar për secilin rast gjatë 3 fazave të programit përfshin:

Këshillimi psikosocial: Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, janë mbështetur me këshillim psiko-social nga psikologjia e organizatës dhe nga menaxherët e rasteve. Çështjet e sjella në këshillim janë kryesisht të lidhura me punësimin, marrëdhëniet ndërpersonale, ndërmjetësimin me familjen, fuqizimin, menaxhimin e kohës dhe të ardhurave, vendimmarrjen dhe zgjedhjet, prindërimin, arsimin, vetë-kujdesin dhe jetesën e pavarur.

351 seanca këshillimi individuale janë ofruar nga psikologjia e D&E për përfituesit e tre fazave të programit dhe 1980 seanca këshillimi individual psiko-social janë ofruar nga menaxherët e rasteve.

Terapi arti dhe okupacionale: gjatë kësaj periudhe janë organizuar 16 terapi arti: përgatitja e bizhuterive të personalizuar dhe zbulimi për festat e 7 - 8 marsit, Shën Valentinit, Halloweenit, festën e Pavarësisë dhe të Clirimit 28

- 29 Nëntor, kartolina për festat e fundvitit, vizatime dhe piktura nga vetë përfitueset për një temë të zgjedhur nga vetë vajzat, si: portret, vizatimi i një shoqeje etj.



Mbështetja mjekësore: Mjeku i D&E ka bërë vlerësimin mjekësor të rasteve të reja të hyra në program, ka adresuar dhe ka trajtuar nevojat mjekësore të të gjitha përfituesëve të programit, si dhe fëmijëve të tyre. Për çdo rast të ri të hyrë në program janë bërë analizat rutinë si gjak komplet, bilanc biokimik, eko abdominale, grafi dhe ekzaminime te tjera më

specifike. Rastet të cilat kanë hasur probleme shëndetsore janë referuar te specialistët përkatës dhe janë trajtuar me medikamente. Problemet shëndetësore të cilat janë hasur më shpesh te përfitueset kanë qenë infeksione (virale, bakteriale dhe mykotike), probleme dermatologjike, okulare, dentare dhe gjinekologjike, viroza të stinës, probleme kronike etj. 12 fëmijë të rasteve të akomoduar në strehëz janë ndjekur vazhdimisht te konsultori për vaksina dhe te pediatri i Qendrës Shëndetsore për kontrolle te tjera. 12 raste kanë ndjekur terapi te mjekja psikiatër dhe kanë marrë trajtimin përkatës.

Këshillimi dhe asistencë ligjore: Avokatja e D&E ka bërë vlersimin e nevojave per çdo rast të ri që ka hyrë në programin e D&E. Gjithashtu janë mbështetur me procesin ligjor civil dhe penal, me përfaqësim në gjykatë. Avokatja e D&E organizon tema ligjore të ndryshme si: njohja me instiucionet publike, martesat fiktive, hapja e një llogarie ne E- Albania, informimi për të drejtat e tyre.

Janë mbështetur me ndihmë ligjore parësore dhe dytësore:


nr		<u>Ndihmë juridike parësore</u>	<u>Ndihmë juridike dytësore</u>																						
52	Viktima /viktima të mundshme trafikimi	Informim për Ligjin “Për të drejtat e fëmijës”, statusin e jetimit, denoncimin e të miturit, informacion për të drejtën e takimit me fëmijën e mitur (komunikim me PMF dhe SPZ), informim për zgjidhje martese, ekzekutim vendimi gjyqësor, njohje e atësisë së fëmijës, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, bonus qiraje, transferim vendbanimi.	<table border="1"> <tr> <td>1</td> <td>Përfaqësim në procesin gjyqësor si person i tretë për “Vendosje të fëmijës në institucion”</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Përfaqësim në procesin gjyqësor për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Asistencë në përgatitjen e kërkesës për informacion për ekspuls drejtuar autoriteteve shqiptare dhe të huaja</td> </tr> </table>	1	Përfaqësim në procesin gjyqësor si person i tretë për “Vendosje të fëmijës në institucion”	2	Përfaqësim në procesin gjyqësor për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes	2	Asistencë në përgatitjen e kërkesës për informacion për ekspuls drejtuar autoriteteve shqiptare dhe të huaja																
1	Përfaqësim në procesin gjyqësor si person i tretë për “Vendosje të fëmijës në institucion”																								
2	Përfaqësim në procesin gjyqësor për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes																								
2	Asistencë në përgatitjen e kërkesës për informacion për ekspuls drejtuar autoriteteve shqiptare dhe të huaja																								
44	Përfituese viktima të dhunës në marrëdhëni e familjare	Viktimat e dhunës janë informuar për zgjidhje martese, urdhër mbrojtje, takimin e prindit me fëmijën, pagesën e ndihmës ekonomike si viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare, bonusin e qirasë, transferimin e vendbanimit etj.	<table border="1"> <tr> <td>18</td> <td>Asistencë në hartimin e padisë për zgjidhje martese dhe përfaqësim në gjykatë për zgjidhje martese</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ndihmë për urdhër mbrojtje</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Ankim në Gjykatën e Apelit për urdhër mbrojtje</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Përfaqësim i viktimës së dhunës në proces penal dhe 2 fëmijët e saj të mitur janë përfaqësuar si viktima të veprës penale “Keqtrajtim të mituri”</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Përfaqësim në proces penal si viktimë e dhunës në familje e përsëritur në prezencë të fëmijëve</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Përfituese pjesëtim pasurie</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Lëshim autorizimi për fëmijët për të udhëtuar jashtë shtetit</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Asistencë në përgatitjen e ankimit urdhri ekzekutimi me gjobë i përmbaruesit</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Përfaqësim në procesin gjyqësor për ndryshim vendimi gjyqësor lidhur me të drejtën takimi me fëmijët</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ndihmë për urdhër mbrojtje</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Ankim në Gjykatën e Apelit për urdhër mbrojtje</td> </tr> </table>	18	Asistencë në hartimin e padisë për zgjidhje martese dhe përfaqësim në gjykatë për zgjidhje martese	2	Ndihmë për urdhër mbrojtje	1	Ankim në Gjykatën e Apelit për urdhër mbrojtje	1	Përfaqësim i viktimës së dhunës në proces penal dhe 2 fëmijët e saj të mitur janë përfaqësuar si viktima të veprës penale “Keqtrajtim të mituri”	2	Përfaqësim në proces penal si viktimë e dhunës në familje e përsëritur në prezencë të fëmijëve	1	Përfituese pjesëtim pasurie	2	Lëshim autorizimi për fëmijët për të udhëtuar jashtë shtetit	1	Asistencë në përgatitjen e ankimit urdhri ekzekutimi me gjobë i përmbaruesit	1	Përfaqësim në procesin gjyqësor për ndryshim vendimi gjyqësor lidhur me të drejtën takimi me fëmijët	2	Ndihmë për urdhër mbrojtje	1	Ankim në Gjykatën e Apelit për urdhër mbrojtje
18	Asistencë në hartimin e padisë për zgjidhje martese dhe përfaqësim në gjykatë për zgjidhje martese																								
2	Ndihmë për urdhër mbrojtje																								
1	Ankim në Gjykatën e Apelit për urdhër mbrojtje																								
1	Përfaqësim i viktimës së dhunës në proces penal dhe 2 fëmijët e saj të mitur janë përfaqësuar si viktima të veprës penale “Keqtrajtim të mituri”																								
2	Përfaqësim në proces penal si viktimë e dhunës në familje e përsëritur në prezencë të fëmijëve																								
1	Përfituese pjesëtim pasurie																								
2	Lëshim autorizimi për fëmijët për të udhëtuar jashtë shtetit																								
1	Asistencë në përgatitjen e ankimit urdhri ekzekutimi me gjobë i përmbaruesit																								
1	Përfaqësim në procesin gjyqësor për ndryshim vendimi gjyqësor lidhur me të drejtën takimi me fëmijët																								
2	Ndihmë për urdhër mbrojtje																								
1	Ankim në Gjykatën e Apelit për urdhër mbrojtje																								
5	Përfituese viktima të abuzimit seksual	Informim mbi të drejtat e viktimës së abuzimit seksual në proces penal	<table border="1"> <tr> <td>1</td> <td>Përfaqësim në Gjykatën e Apelit si viktimë e veprës penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë të mitura”</td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Përfaqësim në procesin për zgjidhje martese dhe në procesin penal si viktimë e dhunës në familje</td> </tr> </table>	1	Përfaqësim në Gjykatën e Apelit si viktimë e veprës penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë të mitura”	1	Përfaqësim në procesin për zgjidhje martese dhe në procesin penal si viktimë e dhunës në familje																		
1	Përfaqësim në Gjykatën e Apelit si viktimë e veprës penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë të mitura”																								
1	Përfaqësim në procesin për zgjidhje martese dhe në procesin penal si viktimë e dhunës në familje																								
13	Përfituese që kanë marrë bonusin e qirasë, janë mbështetur me përgatitjen e dokumentave për aplikim në Bashki																								

Edukimi dhe shkollimi: 68 raste dhe 146 fëmijë të tyre ndjekin shkollën (nga këto 57 raste janë VT/VMT dhe 20 fëmijë të tyre, 11 raste VDH / VAS dhe 126 fëmijë të tyre). Mësuesja e D&E ka bërë vlerësimin e nevojave arsimore për çdo rast të ri që ka hyrë në program. Rastet janë pajisur me mjete shkollore dhe me libra sipas nevojës.

Kurse Profesionale/Punësimi: D&E ka mbështetur përfituesit e programit në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun formal të punës. Stafi i D&E orienton në mënyrë të vazhdueshme përfituesit të zgjedhin profesione të kërkuara në tregun e punës, duke u përshtatur në çdo rast me aftësitë e tyre personale. Përfituesit trajnohen për të qenë të përgatitur në intervista pune, të kenë një komunikim efektiv me punëdhënësin, si të përgatisin një CV, letër motivimi etj. Të gjitha rastet e reja në program janë shoqëruar nga koordinatori për fuqizimin ekonomik për t'u regjistruar pranë Zyrrave të Punës si punëkërkuese të papuna në mënyrë që të marrin oferta për kurse profesionale ose punësim.

Kurse Profesionale	Numri i Rasteve
Gjuha italiane (në qendra private të kurseve)	5
Gjuha angleze (pranë QFP4)	1
Parukeri (në një biznes privat)	1
Marketing (Itech Academy)	1
Menaxhim biznesi (Elita Academy)	1
Kuzhinë (pranë QEK)	4
Klubi i parukierisë dhe estetikës në klubin social D&E	15
Gjuha gjermane (Opportunity Center)	2 (fëmijë të përfitueseve)
Totali	30

Programe internshipi	Numri i Rasteve
Program internshipi Ndhmës kuzhinierë	2 (në dy restorante të ndryshme)
Program internshipi Banakier	1
Program internshipi Marangoz në dyqan mobiljesh	1
Totali	4



Koordinatorja e Fuqizimit Ekonomik të D&E ka qenë në marrëdhënie të ngushta me bizneset private të përfshira në programin e praktikës, si dhe me përfituesit duke synuar t'u ofrojë atyre mbështetje të vazhdueshme fillimisht për t'u përshtatur në vendin e punës dhe më pas për të kapërcyer vështirësi të ndryshme që mund të hasin.

Aktivitetet brenda dhe jashtë strehëzes: diskutime grupi me tema të ndryshme, përgatitja për festat zyrtare dhe ditëlindjet e përfitueseve, workshope kuzhine nëpërmjet të cilave përfitueset mësojnë të gatujnë receta gatimi, aktivitete kreative, lojra bashkëpunimi, mbrëmje muzikore të organizuara çdo të shtunë, leximi i librave nga biblioteka e D&E, fitness, palestër, yoga, meditim, kafe në oborr etj.



Edhe jashtë strehëzes u organizuan një sërë aktivitete me karakter zbavitës dhe informues si festimi i festave kombëtare, ekskursione në qendrën e lojërave Latitude, si dhe në hapësira të tjera me kënde lojërash për fëmijë, shëtitje në park, shopping, vajtje në plazh etj.

Monitorimi i rasteve në apartament dhe familje: 237 raste dhe 272 fëmijë të tyre asistohen në apartament me qira dhe në familje. Nga këto raste 125 janë VT/VMT dhe 47 fëmijë të tyre, ndërsa 112 janë viktime të dhunës në familje dhe abuzimit seksual dhe 225 fëmijë të tyre.

Përfitueset e fazës së dytë e të tretë të programit të D&E janë mbështetur me të gjitha shërbimet në komunitet bazuar në nevojat e tyre. Monitorimi i përfituesve është kryer me anë të takimeve direkte, ashtu si me anë të kontaktimit të rregullt me telefon nga menaxherët e rasteve. Sesione të rregullta këshillimi janë ofruar nga psikologjia e D&E për përfituesit e programit, të cilët janë aktualisht në fazën e dytë të riintegrit. Gjatë kësaj periudhe stafi ka monitoruar dhe ka organizuar takime direkte me përfitueset të cilat banojnë në qytetet e tyre të origjinës si Shkodër, Fier, Durres, Elbasan, Korçë, Berat, Kukës, Diber.

3.2. Rritja e përpjekjeve për identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet Njësive Lëvizëse

Gjatë vitit 2023, D&E ka vazhduar përpjekjet për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit përmes organizimit të punës në terren. Dy njësitë lëvizëse (Mobile Unit) Tiranë dhe Shkodër të përbërë nga dy persona (punonjës social) për çdo njësi, kanë punuar në mënyrë aktive për këtë qëllim, duke kontaktuar drejtpërdrejt me persona në rrezik trafikimi dhe shfrytëzimi. Ekipet e Njësive Lëvizëse kanë kontaktuar me familje dhe kanë vlerësuar nëpërmjet treguesëve të mundshëm rastet në rrezik trafikimi dhe shfrytëzimi. Kështu, gjatë kësaj periudhe Njësitë Lëvizëse kanë kontaktuar drejtpërdrejt me **433 persona** të cilët vijnë nga familje apo grupe vulnerabël të cilët janë ndërmjetësuar për të marrë shërbime të ndryshme si: shërbime mjekësore, shërbime për gjetjen e një vendi pune apo për plotësimin e dokumentave të tjera për bonus qiraje, ndihmë ekonomike apo për përfitimin e një banese

35 raste dhe 11 fëmijë të tyre janë identifikuar si viktime të mundshme trafikimi dhe janë referuar tek Autoriteti Përgjegjës.
sociale.

Aktivitetet e tjera që Njësitë Lëvizëse kanë ndërmarrë janë organizimi i fokus grupeve me pjesëtarët e këtyre komuniteteve në nevojë, duke diskutuar tema lidhur me trafikimin dhe shfrytëzimin e personave, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit. **Njësitë Lëvizëse** kanë bashkëpunuar me organizata dhe institucione të tjera përgjatë punës së tyre, përfshirë **144 profesionistë.**

Gjatë kësaj periudhe stafi i D&E ka marrë pjesë në takime të grupeve teknike ndërsektoriale të organizuara nga Njësitë Administrative dhe Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, për të diskutuar raste të cilat kanë pasur nevojë për mbështetje.

3.3. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për çështje të trafikimit, dhunës dhe abuzimit

Takime / Fokus grupe me profesionistë

- **14.02.2023** njësia Lëvizëse e Tiranës organizoi një takim me 17 punonjësit e policimit në komunitet pranë komisarariatit nr.2 Tiranë. Qëllimi i këtij takimi ishte rritja e bashkëpunimit për identifikimin proaktiv dhe referimin e rasteve Viktima/Viktima të Mundshme të Trafikimit.



- **13.10.2023** Aktivitet i realizuar me ndërlidhësit e komunitetit të Njësisë Administrative Bërzhitë. Ky aktivitet u zhvillua nga Njësia Lëvizëse Tiranë në bashkëpunim me Njësinë e



mbrojtjes së fëmijëve Bërzhitë. Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit mes MU Tirana dhe ndërlidhësve të komuniteteve të Njësisë administrative Bërzhitë. U diskutuan çështje që lidhen me trafikimin e personave përfshirë parandalimin, identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Gjithashtu u shperndanë materiale informuese për shërbimet që ofron organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, kontaktet ku mund të kërkojnë ndihmë individët e riskuar dhe për adresimin e problemeve të ndryshme që mund të kenë individët, familjet apo grupet vulnerabël të komunitetit të Njësisë Bërzhitë.

- **16.10.2023** në Bashkinë e Vorës. Takim informues me profesionistë të stafeve psiko-sociale shkollorë. Aktiviteti u realizua nga MU Tirana në bashkëpunim me psikologun e shkollës së mesme “Isa Boletini” Vorë dhe Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve. Temat e trajtuara ishin në lidhje me: “Të miturit në konflikt me ligjin” dhe adresimin e problematikave në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu u diskutua dhe për rastet e fëmijëve që pavarësisht konflikteve që kanë vetë ato me ligjin, mund të jenë gjithsesi në situatë shfrytëzimi apo trafikimi nga persona të tjerë. Në këto raste u diskutua



për trajtimin dhe mbrojtjen e tyre jo si fëmijë në konflikt me ligjin, por si viktimë (të mundshme) trafikimi. Në këtë takim u shperndanë materiale informuese nga avokatja e organizatës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit shqiptar dhe konventave ndërkombëtare, si dhe për mënyrat e identifikimit dhe referimit të tyre në institucionet përkatëse. Pjesëmarrës në takim ishin psikologë të shkollave, punonjës socialë, punonjëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe oficerë të sigurisë në shkolla.

- Takim informues me profesionistë të Shërbimit Shëndetësor Parësor të Poliklinikës nr. 9 në Tiranë. Ky takim u realizua nga Njësia Lëvizëse Tiranë në bashkëpunim me stafin psiko - social të qendrës shëndetësore dhe Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit.



- **1.12.2023** Kamëz, pranë komisarariatit nr.5. Njësia Lëvizëse e Tiranës zhvilloi një takim informues me pjesëmarrjen e 10 punonjësve të policimit në komunitet (SPZ-te). Qëllimi i takimit ishte rritja dhe forcimi i bashkëpunimit mes policisë dhe Njesisë Lëvizëse për identifikimin dhe referimin e rasteve viktime të mundshme të trafikimit, diskutim për individët që janë të dhunuar, si dhe për fëmijët që janë në konflikt me ligjin, pasi janë faktorë të lidhur drejtpërdrejtë me rritjen e riskut për të ndodhur shfrytëzimi dhe trafikimi.
- **15.12.2023** në Njësine Administrative Farkë u organizua një takim me Ndërlidhësit e Komunitetit të kësaj Njësie.
- **18.12.2023** në Bashkinë e Kamzës u organizua takimi i rradhës me Ndërlidhësit e Komunitetit të kësaj Bashkie.



Sesione informimi

Data	Institucioni	Pjesëmarrja	Qyteti / Njësia Administrative
10 tetor	shkollat 9-vjecare "100 Vjetori" dhe "Arberia"	75 nxënës të klasave të VIII dhe të IX	Kamëz
10 tetor	shkolla e mesme profesionale "Hamdi Bushati"	Njësia lëvizëse Shkodër (D&E) bashkëpunim me stafin psiko - social	Shkodër
13 tetor	shkolla e mesme "Eqerem Cabej"	42 nxënës nga klasat e X dhe XI	Tiranë, Njësia nr.4
	shkolla e mesme jo-publike "Tirana Jonë"	35 nxënës të klasës së XI.	
17 tetor	shkolla 9-vjecare "Hasan Prishtina"	20 nxënës të klasave të VIII	Tiranë, Njësia nr.3
17 tetor	shkolla 9-vjecare "Skënder Luarasi"	35 nxënës të klasës së IX	Tiranë, Njësia nr.11
18 tetor	shkolla e mesme "28 Nëntori"	Njësia Lëvizëse Shkodër nëbashkëpunim me stafin psiko-social dhe përfaqësues të KRAT prefektura e rrethit Shkodër	Shkodër
18 tetor	gjimnazet "Qemal Stafa" dhe "Asim Vokshi"	60 nxënës të klasave të X dhe të XI	Tiranë, Njësia nr.10
20 tetor	gjimnazi "Alush Bardhi"	30 nxënës të klasave të X	Farkë, Tiranë
20 tetor	shkolla e mesme Shejnaze Juka	Stafi i Qendrës Komunitare të lagjes nr.1	Shkodër
24 tetor	shkolla "Niket Dardani"	32 nxënës të klasës së IX	Tiranë, Njësia nr.1
24 tetor	gjimnazi "Sadik Stavaleci"	33 nxënës të klasave të X dhe XI	Kashar, Tiranë
27 tetor	shkolla 9-vjecare "Vaçe Zela"	30 nxënës të klasave të VIII	Tiranë, Njësia nr.11
30 tetor	shkolla 9-vjecare "Drita Pelinku"	30 nxënës të klasave të IX	Tiranë, Njësia nr.7

30 tetor	Njësia Lëvizëse Shkodër (D&E)	Punë në terren, informimi i punonjësve të taksive dhe shërbimet e hoteleri - turizëm	Shkodër
31 tetor	shkolla 9-vjecare		Kavajë
	" Fiqiri Kurti "	35 nxënës të klasave të VIII dhe të IX	
	" Gjimnazi Luz "	45 nxënës të klasave të X dhe XI	Kavajë
		35 nxënës të klasave të XI.	Dajt, Tiranë
7 nëntor	gjimnazi "Ymer Lala"	20 studentë të degës së punës sociale dhe psikologjisë	Tiranë
8 qershor	Universiteti privat "Marin Barleti"	35 nxënës të klasës së 9-të, stafi psiko-social i shkollës dhe CPW	Tiranë
12 qershor	shkolla 9-vjecare "Shkolla e Kuqe"		



Fokus grupe

- **3 fokus grupe** të organizuara (një në Shkodër dhe dy në Tiranë) me pjesëmarrjen e 36 individëve nga komuniteti rom. Fokus grup i organizuar në bashkëpunim me Qendren Sociale "Gonxhe Bojaxhiu" Tiranë i realizuar me disa nga perfituesit e qendrës sociale.
- Njësia Lëvizëse Shkodër në bashkëpunim me stafin e qendrës komunitare të Shëndetit Mendor, organizoi fokus grup me gra të këtij komunitetit. Ky fokus grup u përqëndrua në ndërgjegjësimin dhe informimin për rrezikun e trafikimit.

3.4. Ofrimi i shërbimeve alternative (paradite dhe pasdite) të përkujdesjes së fëmijëve. Për fëmijët e nënave që janë duke rindërtuar jetën e tyre. GIZ, UNICEF dhe donatorë të tjerë.

"Shtëpia e Gjyshes / Shtëpia Tjetër" është një shërbim komunitar që ofron përkujdesje ndaj fëmijëve të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje, që të marrin kujdesin e duhur pasdite dhe të rriten në një mjedis të qetë, të sigurtë dhe nën përkujdesje përtej orarit zyrtar të çerdheve, kopshteve dhe shkollave publike (nga e hëna në të shtunë).

Shërbimet që iu ofrohen fëmijëve gjatë qëndrimit në alternativën e përkujdesit:

- Përkujdesje dhe mbikqyrje
- Kujdes për Higjenën dhe Shëndetin
- Ushqim dhe ushqyerja
- Mbështetje për shkollën/detyrat e shtëpisë
- Mbështetje emocionale dhe mësimi i sjelljeve pozitive sociale
- Lojëra argëtuese
- Informimi dhe konsultimi me nënën lidhur me kujdesin për fëmijën
- Observimi i sjelljeve të fëmijës dhe raportimi i dyshimeve për neglizhim, abuzim apo ekspozim ndaj dhunës
- Vlerësimi dhe mbështetja psikologjike/mjekësore
- Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i kujdesit
- Transporti
- Shëtitje
- Referimi i nënave dhe fëmijëve për vlerësimin dhe trajtimin e nevojshëm
- Mbështetje prindërimi për nënat

Nga ky shërbim përkujdesi kanë përfituar gjatë kësaj periudhe **24 fëmijë** (8 djem, 16 vajza) dhe **18 familje/nëna të vetme**:

- Alternativa e Përkujdesit Shkozë është frekuentuar nga 7 fëmijë (3 djem, 2 vajza). Janë mbështetur 6 nëna për të punuar me kohë të plotë.
- Alternativa e Përkujdesit Shkodër është frekuentuar nga 7 fëmijë (2 djem, 5 vajza). Janë mbështetur 5 nëna për të punuar me kohë të plotë.
- Alternativa e Përkujdesit Dajç është frekuentuar nga 10 fëmijë (3 djem, 7 vajza). Janë mbështetur 6 nëna për të punuar me kohë të plotë.

Fëmijët që frekuentojnë këtë shërbim kanë shfaqur përmirësim të dukshëm dhe të qëndrueshëm të mirëqenies emocionale dhe psikologjike, në procesin e të nxënimit si dhe në arritjen e rezultateve më të mira në shkollë. Shërbimi është ngritur dhe funksionon mbi bazën e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore. Një pjesë e kostove operative për funksionimin e shërbimit dhe mjediset ofrohen nga Bashkitë Tiranë dhe Shkodër, ndërsa kostot e tjera mbulohen me mbështetjen financiare të donatorëve.

3.5. Rritja e kapaciteteve për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit dhe individë të tjerë vulnerabël nëpërmjet fuqizimit të profesionistëve të ligjit dhe avokatisë “probono”

Qëllimi i projektit ishte ofrimi i ndihmës juridike falas për viktimat e krimit dhe individët e marginalizuar përmes kapaciteteve të organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë” dhe rrjetit të avokatëve “probono” në nivel kombëtar dhe vendor. Nëpërmjet këtij projekti u rritën kapacitetet vendore për referimin e rasteve me nevoja ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas, duke shfrytëzuar kapacitetet vendore, nëpërmjet profesionistëve të ligjit dhe avokatisë “probono”.

Aktivitetet gjatë periudhës Janar - Nëntor 2023 janë fokusuar në:

Ofrimi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore me avokat

Projekti i zbatuar nga D&E ka mundësuar që të vijojë pa ndërprerje ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjitha rastet që janë referuar për ndihmë juridike pranë D&E, përfshirë edhe rastet që janë pjesë e programit të riintegrit. Gjatë periudhës dhjetor 2023 - nëntor 2024 kanë marrë ndihmë juridike gjithsesj **312 përfitues (42 prej tyre kanë marrë ndihmë juridike parësore dhe dytësore)**. Ndihma juridike falas mundësoi një paketë të plotë shërbimesh sipas nevojave të përfituesve, duke përfshirë informacion mbi të drejtat e tyre ligjore, vlerësimin e nevojës për ndihmë juridike, përgatitjen e dokumentacionit për çështje të ndryshme gjyqësore (penale, civile dhe administrative), ndihmë juridike në aplikime dhe kërkesa për shërbime të ndryshme, përfshirë përfaqësimin në Gjykata dhe Institucione. Për ofrimin e ndihmës juridike falas D&E ka përdorur edhe



linjën e këshillimit ligjor me dy numra telefoni fiks dhe të lëvizshëm, të cilët përdoren rregullisht nga përfituesit për të marrë shërbimet ligjore sipas nevojave të tyre. Linja e këshillimit është përdorur mesatarisht nga **35 përfitues në muaj dhe në total 422 përfitues** për periudhën dhjetor 2022 - nëntor 2023 (disa përfitues kanë përdorur linjën e këshillimit më shumë se një herë).

Organizimi i 4 tryezave (multidisiplinare) të rrumbullakëta në Kukës, Lezhë, Dibër dhe Shkodër me temë “*Sfidat dhe mundësitë për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit*”. Këto tryeza kanë pasur për qëllim krijimin dhe funksionimin e një rrjeti në nivel vendor për referimin e rasteve dhe ofrimin e ndihmës ligjore falas për viktimat e krimit dhe grupet në nevojë.

Gjatë periudhës mars - qershor 2023 janë zhvilluar 4 tryeza si më poshtë:

Kukës	28.04.2023	12 pjesëmarrës
Dibër	06.06.2023	15 pjesëmarrës
Lezhë	15.06.2023	11 pjesëmarrës
Shkodër	23.06.2023	20 pjesëmarrës

Në këto qytete janë zhvilluar edhe **ditë të hapura për ndihmën ligjore falas (Street law activities)**. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte që të ndërgjegjësojmë qytetarët, në veçanti grupet në nevojë, për t’ju drejtuar agjencive përkatëse për të përfituar ndihmë juridike falas. Gjatë periudhës qershor - korrik 2023, u organizuan 4 ditë të hapura: në Dibër më 29 qershor; në Lezhë më 30 qershor; në Kukës më 11 korrik; dhe në Shkodër më 21 korrik.

Gjatë muajve shtator - tetor 2023, u zhvilluan **3 trajnime në Elbasan, Berat dhe Shkodër** me juristë dhe profesionistë juridikë nga 12 qarqet e vendit (përfshirë pjesëmarrës nga katër rrethet Shkodër, Lezhë, Dibër dhe Kukës), me pjesëmarrjen e 74 personave. Tema e trajnimeve ishte “*Rritja e kapaciteteve të avokatëve dhe profesionistëve të ligjit për të ofruar ndihmë juridike falas për viktimat e krimit*”. Gjatë trajnimeve u diskutuan tema të ndryshme për ndihmën juridike falas, duke theksuar rolin e rëndësishëm që kanë avokatët dhe profesionistët juridikë në mbrojtjen dhe përfaqësimin ligjor të viktimave të krimit. Në përfundim të trajnimeve u pajisën me çertifikatë pjesëmarrjeje 70 avokatë dhe profesionistë të ligjit nga të gjitha qarqet e vendit. Më poshtë janë datat, vendet dhe numrii pjesëmarrësve për çdo trajnim:

Elbasan	22.09.2023	22 pjesëmarrës
Berat	29.09.2023	20 pjesëmarrës
Shkodër	06.10.2023	28 pjesëmarrës

Në përfundim të projektit, më **23 nëntor 2023**, u zhvillua në Tiranë aktiviteti final “**Forumi i Hapur**”, me rastin e nisjes së fushatës “**16 ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore**”. Për realizimin e këtij aktiviteti D&E ka bashkëpunuar me UNDP, Ministrinë e Drejtësisë dhe institucione të tjera. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 50 përfaqësues nga

Institucione dhe Organizata të ndryshme, juristë dhe profesionistë të ligjit, si dhe përfaqësues të lartë të institucioneve të rëndësishme, organizatave ndërkombëtare, donatorë dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile. Tema e "Forumit të Hapur" ishte "Avokimi për ndryshim: Ndhima juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupet e cënueshme" dhe u organizua si një forum i hapur diskutimi mbi ndihmën juridike falas, si një reflektim i përbashkët për të përmirësuar mbrojtjen e viktimave, akses në drejtësi dhe shërbime të tjera të përshtatura për nevojat e tyre. Gjatë këtij aktiviteti janë paraqitur disa sugjerime dhe ndërhyrje për përmirësimin e bazës ligjore që rregullon shërbimin juridik "pro bono". Në fund të aktivitetit u shpërndanë çertifikata mirënjohjeje për 3 avokatë aktivë në ofrimin e ndihmës juridike "pro bono", si vlerësim dhe motivim për kontributin e tyre.



3.6. Konsolidimi i Sistemeve për Fuqizimin e Viktimave në Shqipëri, Shkodër (TVESA@Sh). Bashkimi Evropian në kuadër të programit "Mbështetja e BE-së për Përfshirjen Sociale në Shqipëri"

Projekti synon të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve sociale për të mbijetuarat e trafikimit dhe dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër, sipas nevojave të tyre si dhe në zhvillimin e politikave që ndikojnë në jetën e tyre. Projekti po kontribuon në zgjerimin e modeleve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit social në Bashkinë e Shkodrës, duke përfshirë kujdesin ndaj fëmijëve, dhe në të njëjtën kohë mbështetjen e të mbijetuarve të trafikimit dhe dhunës me bazë gjinore për të krijuar bizneset e tyre sociale lokale.

Gjatë kësaj periudhe, që nga fillimi i projektit në Maj 2022 deri në Dhjetor 2023 janë mbështetur në total me të gjitha shërbimet riintegruese: **56 raste** (48 vajza/gra dhe 8 djem); 60 fëmijë dhe 11 familjarë të tyre; si dhe 10 fëmijë (7 vajza, 3 djem) në Alternativëne Përkujdesit Pasdite Dajç, si dhe 10 femije (8 vajza, 2 djem) në Alternativën e Përkujdesit Pasdite Shkodër.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 janë realizuar këto aktivitete të projektit:

Workshop - Shkëmbim Eksperiencash, 11 dhe 13 Shkurt 2023



Përgatitja dhe organizimi i "Workshopeve për Shkëmbimin e Eksperiencave" u organizuan ndërmjet organizatave partnere dhe Bashkisë Shkodër. Aktivitetet u ndërtuan mbi gjetjet e vlerësimit, duke përfshirë 2 workshope që u mbajtën në Shkodër, ku morën pjesë gjithsej 30 pjesëmarrës (25 F, 5 M), 21 pjesëmarrës nga stafi i komunës dhe 9 pjesëmarrës nga organizatat (D&E dhe KMOP).

Ditët e trajnimit lehtësuan transferimin e njohurive dhe përvojës, siguruan që stafi i bashkisë u pajis dhe fuqizua kompetencat e nevojshme në lidhje me ofrimin e shërbimeve të viktimave, ndërsa kapaciteti i stafit të organizatave u fuqizua

me aftësi dhe kompetenca për të ndihmuar individët e tjerë të cënueshëm ose për të adresuar nevojat e viktimave me të cilat bashkia kishte përvojë.

Në ditën e parë të seminarit u diskutuan këto çështje: Prokurimi sipas legjislacionit shqiptar; Prokurimi sipas PRAG; Njohja e limiteve personale dhe profesionale; Burn-out dhe Bore out; Menaxhimi i stresit në punë. Gjatë ditës së parë të workshopit morën pjesë gjithsej 24 pjesëmarrës (21F, 3M; ku 17 pjesëmarrës ishin nga bashkia dhe 7 nga organizatat).

Në ditën e dytë të workshopit u diskutuan këto çështje: Përditësimi i legjislacionit në lidhje me detyrat funksionale të subjekteve; Aksesimi në drejtësi dhe ndihmë juridike për viktimat; Menaxhimi i rasteve me nivel të lartë rreziku për komunitetin; Proçedurat për përfitimin nga bashkia të bonusit të qirasë, ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar. Gjatë ditës së dytë të workshopit morën pjesë gjithsej 20 pjesëmarrës (18F, 2M; ndër të cilët 13 pjesëmarrës ishin nga bashkia dhe 7 nga organizat partnerë).

8 Mars 2023 Në kuadër të *Ditës Ndërkombëtare të Gruas*, u organizua në Bashkinë e Shkodrës aktiviteti “*Ti je Shembull*”. Gra të forta, të guximshme, profesioniste të afta, nëna dhe bashkëshorte modele, studente ekselente dhe biznesmene të suksesshme ndanë historitë e tyre në rrugëtimin jetësor dhe kontributin e tyre në zhvillimin e zonës së Bërdicës dhe Dajçit, duke dhënë kështu shembullin se pavarësisht vështirësive e pengesave, gruaja ia del mbanë. Të gjitha gratë pjesëmarrëse kaluan një kohë të mirë, me mesazhin se së bashk mund të arrijmë të kontribuojmë për të drejtat dhe barazinë e grave dhe të shikojmë drejt një të ardhmeje më të mirë për të gjitha vajzat dhe gratë. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 30 vajza dhe gra nga Bërdica dhe zona e Dajçit, përfaqësuese të sektorit privat që punojnë në këto zona.



05 Djetor 2023 Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore u inagurua Klubi i Kauzës Sociale në Dajç, së bashku me Bashkinë e Shkodrës dhe KMOP - Qendra për Veprim Social dhe Inovacion (Greqi), me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Klubi i Kauzës Sociale shërben si një vend socializimi për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, për të marrë mbështetje psikologjike dhe ligjore, si dhe për të fituar njohuri të reja dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre për më shumë mundësi punësimi. Klubi Social dhe **Alternativa e Kujdesit Pasdite për Fëmijët** janë ngritur në ambientet e Qendrës Komunitare për Familjen me qëllimin për t'u shërbyer vajzave dhe grave të zonës për fuqizimin ekonomik të tyre, kujdesin e fëmijëve, si dhe përfshirjen sociale të gjithë komunitetit. Në inaugurimin e Klubit të Kauzës Sociale morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga Delegacioni i BE-së, Bashkia Shkodër, Të Ndryshëm dhe të Barabartë dhe KMOP, si dhe përfaqësues nga Njësia Administrative Dajç, institucionet lokale, biznese private, gra dhe vajza të zonës, duke përfshirë edhe viktimat e dhunës me bazë gjinore, si dhe banorë të zonës.

Ekipi i projektit ka mbështetur përfitueset e programit në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun formal të punës dhe i ka udhëzuar ato të zgjedhin profesionet e kërkuara në tregun e punës, duke iu përshtatur në çdo rast aftësitë e tyre personale. Përfituesit trajnohen se si të paraqiten para punëdhënësit, si të kenë një komunikim efektiv me punëdhënësin, por edhe si të kenë sukses në punë, si të përgatisin një CV, një letër motivimi etj. Të gjitha

rastet shoqërohen nga koordinatori për fuqizimin ekonomik për t'u regjistruar në Zyrën e Punësimit si punëkërkues të papunë. Janë punësuar 9 raste (3 VMT, 6 VDH), ndër të cilat 3 raste VDH janë vetëpunësuar dhe 1 rast VDH ka filluar një kurs profesional gatimi në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional në Shkodër.

Reflektimi i përbashkët i mësimëve të nxjerra dhe rekomandimeve

Ky aktivitet konsiston takime të rregullta ndërmjet organizatave partnere dhe stafit të bashkisë në lidhje me: Modalitetet e themelimit, modifikimet e nevojshme për Klubin e Kauzës Sociale në Dajç; shkëmbimi i eksperiencës; periudhën e ardhshme programore. Aktiviteti është zhvilluar përgjatë projektit. Në këto takime partnerët kanë reflektuar mbi mësimet e nxjerra dhe kanë dhënë rekomandime për periudhën e ardhshme programore. Janë organizuar rreth 16 takime (fizikisht dhe online) ndërmjet organizatave partnere dhe stafit të bashkisë.

Mbështetje ndërmjet profesionistëve të fushës së organizatave/partnerëve të projektit dhe stafit të bashkisë

Profesionistët e organizatës dhe stafi i bashkisë kanë bashkëpunuar në baza ditore për koordinimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër. Profesionistët e organizatës kanë marrë pjesë në 8 grupe teknike ndërsektoriale të organizuara nga bashkia me ofrues të shërbimeve lokale për referimin dhe menaxhimin e rasteve. Profesionistët e organizatës dhe stafi i bashkisë kanë organizuar rreth 16 takime për menaxhimin e rasteve dhe procesin e riintegritit të tyre.



Ngritja dhe mbështetja e funksionimit të 4 bizneseve të viktimave në Shkodër

Janë përzgjedhur, vlerësuar dhe fuqizuar 4 raste viktimave të dhunës me bazë gjinore, për t'i mbështetur për hapjen e bizneseve të reja në Shkodër (një serë, një furrë prodhimesh brumi, një bletari dhe një biznes punimesh artizanale). Rastet po përgatiten për hartimin e planeve të biznesit dhe hapat e mëtejshëm.

3.7. Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit. Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) / Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte rehabilitimi ndaj të gjitha formave të dhunës duke ofruar këshillim dhe aktivitete ku trajtohen shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve pjesë e komunitetit, viktimave të trafikimit, viktimave të mundshme të trafikimit, viktimave të abuzimit seksual dhe dhunës në familje nga moshën 15 deri në 29 vjeç.

37 raste viktimave të trafikimit, abuzimit seksual dhe dhunës në familje të moshës 15-29 vjeç morën pjesë në aktivitetet e organizuara në kuadër të këtij projekti, duke ofruar nxitjen e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, mendore dhe emocionale të tyre.

AKTIVITETI 1: FITNESS, PILATES & USHTRIME FIZIKE

Sesionet e Aktivitetit dedikuar Pilates dhe Ushtrimeve Fizike, u fokusuan në teknika të reja të përdorura në këtë target grup, që janë pritur më së miri dhe në vijim tësesionit të parë kemi pasur një rritje të pjesëmarrjes. Secili sesion ka zgjatur 2 orë, me një pjesëmarrje deri në 20përfituese të programit të organizatës. Pilates dhe ushtrimet e frymëmarrjes kanë ndihmuar në reduktimin e ankthit dhe sulmeve të panikut tek përfitueset e programit. Jo vetëm që kanë përmirësuar shëndetin fizik dhe kanë ndihmuar në rivendosjen e ekuilibrit emocional, por gjithashtu u ka dhënë përfituesve mundësinë për tu shkëputur nga një jetë plot tension ose stres dhe për tu çlodhur për një periudhë të shkurtër. Pilates është një mënyrë unike për të ndihmuar në rikuperimin nga një përvojë traumatike, kjo sepse nëpërmjet lëvizjeve trupi bën largimin e traumës së mbledhur në muskuj pa u nevojitur të flitet për eksperiencën traumatike.

Sesioni 1	4 Shkurt 2023
Sesioni 2	11 Shkurt 2023
Sesioni 3	18 Shkurt 2023
Sesioni 4	25 Shkurt 2023
Sesioni 5	30 Mars 2023

AKTIVITETI 2: MENAXHIMI I STRESIT DHE RREGULLIMI I TIJ

Sesionet e para te këtij aktiviteti u fokusuan në përdorimin e ushtrimeve të frymëmarrjes, afirmimeve pozitive dhe shkrimin pozitiv. Duke ulur reagimin ndaj stresit, ushtrimet dhe teknikat e vetëdijes sjellin efekte pozitive në të gjithë trupin. Në dy sesionet e fundit (sesioni 4 dhe 5) të Aktivitetit 2 dedikuar Stress Management and self- regulation jane përdorur teknika të ndryshme per vete-rregullimin dhe stresin. Teknika që janë pritur më së miri dhe pjesëmarrëset kane shprehur interesin e tyre. Secili sesion ka zgjatur 2 orë, me një pjesëmarrje në rritje deri në 23 përfituese të programit të organizatës.

Sesioni 1	4 Mars 2023
Sesioni 2	11 Mars 2023
Sesioni 3	18 Mars 2023
Sesioni 4	22Prill 2023
Sesioni 5	29 Prill 2023

AKTIVITETI 3: TEKNIKAT E FRYMËMARRJES, MEDITIM & MUZIKË

Këto sesione u fokusuan në 4 ushtrime kryesore që sugjerohen për personat me probleme me ankthin, stresin ose frymëmarrjen e shpejtë. Duke filluar nga "tapping" në zonat ku akumulohen të gjitha nervat dhe stresi i përditshëm, në yoga stretching, aromatherapy dhe e fundit shavasana. Sesionet e fundit të këtij aktiviteti u fokusuan në ushtrimet e frymëmarrjes, muzikën relaksuese dhe meditimin si mjete të rëndësishme për të rregulluar emocionet. 26 përfituese të programit të organizatës morrën pjesë në sesionet e aktivitetit të tretë.

Sesioni 1	06 Maj 2023
Sesioni 2	20 Maj 2023
Sesioni 3	25 Maj 2023
Sesioni 4	1 Qershor 2023
Sesioni 5	8 Qershor 2023

AKTIVITETI 4: MINDFULNESS & WRITING- FOCUSING, CONCENTRATION, CREATIVE WRITING

Në këtë sesion ekspertët u fokusuan te përdorimi i mjeteve si tingujt e lehte muzikorë për të arritur meditimin dhe relaksim optimal, si dhe ndarja e poezive frymëzuese me pjesëmarrësit duke diskutuar edhe mesazhet e tyre. Në këto sesione u përdorën mjete relaksuese si: tingujt dhe mandala-t për të krijuar një ambient të rehatshëm dhe të sigurt për pjesëmarrësit. Gjithashtu u përdorën mjete relaksuese si: journaling dhe poezitë inspiruese, ku pjesëmarrësit krijuan dhe poezitë e tyre në lidhje me historitë dhe përjetimet e tyre. 22 përfitues të programit të organizatës kanë marrë pjesë në sesionet e aktivitetit të katërt.

Sesioni 1	25 Mars 2023
Sesioni 2	1 Prill 2023
Sesioni 3	8 Prill 2023
Sesioni 4	13 Prill 2023
Sesioni 5	4 Maj 2023

Numri total i pjesëmarrësve në të gjitha aktivitetet e projektit është **37 përfitues** të organizatës D&E.



Të ardhurit në këtë aktivitet i ka shpëtuar jetën vajzës sime. Ajo nuk donte të ikte në shkollë, nuk kishte shoqe dhe rrinte e tërhequr. Tani më kërkon ta sjell te ky program dhe mezi e pret ditën e shtunë. Më thotë: -Mami kënaqem shumë atje, dua të rri me vajzat dhe ti bëjmë ushtrimet bashkë.

Feedback nga pjesëmarrës

Përgatitja e libërthit

Gjate muajit korrik është punuar me ekspertët për përgatitjen e libërthit “Libërth me ushtrime dhe teknika për lirim e stresit” si dhe dizenjimi dhe printimi i tij.

Aktivitetet përmblyës

Takim me përfitueset e programit dhe stafit të D&E për prezantimin e librit. Ky takim i fundit u organizua në muajin Gusht me përfitueset pjesëmarrëse të sesioneve. Gjithashtu morën pjesë në këtë takim punonjëset sociale të organizatës për të diskutuar se si mund t’i përdorin këto mjete edhe për përfitueset e reja të programit të riintegritimit të organizatës. Gjatë aktivitetit u shpërndanë librat dhe një set me materiale për tu përdorur nga përfitueset për çlirim e stresit.



3.8 Fuqizojmë Komunitetin në Bashkinë Lezhë

Qendra “Fuqizojmë komunitetin” në Lezhë është një nga tre qendra të tilla në Shqipëri të ngritura me mbështetjen e UNDP me financimin e USAID. Për funksionimin e qendrës, “Të Ndryshëm & Të Barabartë” po bashkëpunon me Bashkinë Lezhë.



Shtyllat kryesore:

- **Info HUB:** Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për të ndihmuar burrat dhe gratë e grupeve vulnerabël, duke iu ofruar informacion mbi shërbimet mbështetëse në nivel lokal dhe sistemin e referimit të profesionistëve dhe ofruesit e shërbimeve, duke e lidhur individin me të gjitha shërbimet përkatëse lokale, dhe për ta mbështetur atë me procedurat për përfitimin e shërbimeve.
- **Ofrimi I shërbimeve:** Shërbime mbështetëse të integruara të cilat mungojnë dhe që u ofrohen popullatës dhe grupeve më vulnerabël të komunitetit.
- **Parandalimi dhe ndërgjegjësimi:** aktivitetet do të përfshijnë të gjitha grupet e komunitetit me më shumë fokus tek anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, të evakuuarit afganë, prindërit në pritje.

Shërbimet që ofron qendra:

- Vlerësimi i nevojave dhe referim;
- Menaxhim rasti;
- Këshillim psikologjik ballë për ballë dhe në distancë nëpërmjet linjes së këshillimit;
- Mbështetje për mjekim dhe trajtim mjekësor;
- Mbështetje për strehim;
- Mbështetje për trajnime profesionale dhe punësim dhe mbështetje për gjetjen e punësimit;
- Kurse të aftësimi për jetën si p.sh. shkrim-lexim për të rriturit dhe për fëmijët, mbështetje për të mësuarit për fëmijët në konflikt me ligjin ose për fëmijët që kanë mbetur prapa në mësim për shkak të rrethanave sociale dhe familjare;
- Kujdes pas orarit të shkollës për fëmijët e nënave të vetme që janë viktime të dhunës në familje apo viktime të dhunës me bazë gjinore;
- Terapi në ambiente të brendshme dhe të jashtme për personat me aftësi të kufizuara;
- Fizioterapi dhe terapi të foluri etj.

Përfituesit e qendrës janë individë dhe familje vulnerabël në Bashkinë Lezhë përfshirë:

- Gratë dhe vajzat viktime të DhBGj dhe DhF
- Personat me aftësi të kufizuara
- Fëmijët dhe të rinjtë viktime të dhunës dhe abuzimit në familje
- Prindërit në pritje dhe kujdestarët alternativë (prindër kujdestarë, kujdestarë të fëmijëve)
- Të evakuuarit afganë
- Individë nga komuniteti rom dhe egjiptian

Aktivitetet e organizuara

1. Përgatitja e vlerësimit të nevojave lidhur me Zhvillimin e Qendrës “Fuqizojmë Komunitetin” në Bashkinë Lezhë

2. Më datë 4 Maj 2023, në ambientet e Hotel Lisus Lezhë u organizua seminari me temë “Zhvillimi i Qendrës fuqizojmë komunitetin në Bashkinë Lezhë“ .

Qëllimi i seminarit ishte prezantimi te profesionistët si ekspertë dhe kontribues të rëndësishëm të mbrojtjes sociale dhe përmirësimit të jetës së komunitetit të Bashkisë Lezhë i gjetjeve të një vlerësimi të shpejtë që Drejtoria e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Lezhë së bashku me dhe Organizatën Të D&E kanë zhvilluar për transformimin e qendrës Casa Ola në një qendër fuqizimi të komunitetit dhe njëkohësisht kërkimi i opinioneve dhe rekomandimeve konkrete për rolin që duhet të luajë qendra në komunitet.

Në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore u zhvilluan këto aktivitete:

1 Dhjetor 2023 Sesion informimi me Temë “Rritja e ndërgjegjësimit mbi dhunën ndaj grave dhe HIV/AIDS”, në ambjentet e Qendrës së Kujdesit Shëndetësor Lezhë ku morën pjesë 23 pjesëmarrës përfaqësues nga Qendra Shëndetësore, përfaqësues të Shërbimit Social Lezhë, përfaqësues nga NjVKSH Lezhë, gra dhe vajza nga komuniteti.

4 Dhjetor 2023 u zhvillua Eventi Publik me temë “Mirënjohje për gratë”. Ky aktivitet u zhvillua në ambjentet e Njësisë Administrative Shënkoll, Lezhë dhe u diskutua mbi rëndësinë dhe të drejtat e grave, si të drejta themelore; promovimin e modelit të gruas, e cila përballlet me shumë sfida të vështira në jetë si dhe nxitjen e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së komunitetit. "Mirënjohja e Grave" shfaqti udhëtime jetësore të grave duke dhënë mesazhin sepavarësisht sfidave dhe pengesave, këto gra treguan se mund të kapërcejnë çdo gjë. Gra dhe vajza të guximshme, profesioniste, nëna dhe bashkëshorte model, ndanë me ne historitë e tyre. Në aktivitet morën pjesë 30 persona. Në mbyllje të aktivitetit u zhvillua një Ceremoni Mirënjohjeje për gratë dhe vajzat e komunitetit, ku në shenjë mirënjohjeje u ndanë lule dhe paketime me ëmbëlsira për secilën nga pjesëmarrëset ne aktivitet.

6 Dhjetor 2023 u zhvillua një Book Club me të rinj rreth një libribazuar ne histori te verteta. Ky aktivitet u zhvillua në ambjentet e Bibliotekës Lezhë. Libri i zgjedhur për diskutim dhe analizë ishte libri “Legjenda e Rozafatit” nga Mitrush Kuteli si dhe version i përpunuar nga UNDP Shqipëri me titull “Dhe ato jetuan siç deshën përgjithmonë”. Të rinjtë lexuan fragmente të të dy librave, duke nxjerrë mesazhet kyç sipas këndvështrimit të tyre. Më pas ata bënë një analizë krahasuese dhe analogjike për të kuptuar ndryshimet mes versioneve dhe arsye pse janë bërë. Qëllimi i këtij sesiioni ishte evidentimi i stereotipeve dhe paragjytimeve gjinore, gjuhës së përzgjedhur, koncepteve si diskriminimi, hierarkia patriarkale dhe marrëdhëniet gjinore. **Në aktivitet morën pjesë 11 persona.**

7 Dhjetor 2023 U organizua një sesion informimi tek fabrika Mali SH.P.K, Bashkia Lezhë, me temë "Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave në vendin e punës". Gjatë këtij aktiviteti u diskutuan problematikat që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave në vendin e punës, situatave të dhunës dhe bashkëpunimi institucional në lidhje me adresimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave. Në këtë aktivitet morën pjesë 20 gra dhe vajza të punësuar në fabrikën Mali SH.P.K.

11 Dhjetor 2023 U organizua në bibliotekën e qytetit Lezhë, **Forumi i Hapur Publik "FUQIZOJMË GRATË - FUQIZOJMË KOMUNITETIN"** ku morën pjesë Kryetari i Bashkisë Lezhë, përfaqësues të UNDP Shqipëri, autoritetet lokale, përfaqësues të shoqërisë civile, gratë dhe vajzat e komunitetit të Lezhës. Gjatë forumit u prezantuan shërbimet multi-sektoriale që do të ofrohen për grupet vulnerabël në Qendrën "Fuqizojmë Komunitetin" duke nxitur gjithashtu diskutime nga pjesëmarrësit dhe inicitativa të përbashkëta për fuqizimin e komunitetit si mjet për të parandaluar dhe luftuar dhunën me bazë gjinore. Pjesëmarrësit ndoqën një shfaqje teatrale rruge, me mesazhe të fuqizimit dhe rëndësisë së barazisë gjinore. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 50 persona.



Shërbimet e ofruara deri tani

1. Zhvillimi i një modeli gjithëpërfshirës për qendrën 'Fuqizojmë Komunitetin' në Bashkinë Lezhë, duke përfshirë një strukturë funksionale të personelit, si dhe protokollet dhe rregulloret për funksionimin e Qendrës.
2. Bashkëpunimi me institucione lokale dhe organizata të shoqërisë civile gjatë aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore.
3. Marrëveshje për bashkëpunim mes organizates D&E dhe institucioneve të tjera në Lezhë si: AKPA, DRSSSH dhe DRAP.
4. Takime me OJF të tjera në qytetin e Lezhës me qëllim njohje, rrjetëzim, informim dhe ndërgjegjësim rreth aktiviteteve të planifikuara në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore.
5. Stafi i Qendrës "Fuqizojmë Komunitetin" ka marrë pjesë në aktivitete dhe takime të zhvilluara nga Shërbimi Social Lezhë, institucione të tjera shtetërore, shkolla, OJF, etj. me qëllim bashkëpunimin, përfshirjen, orientimin, informimin dhe rrjetëzimin me këto institucione. Në këto aktivitete është prezantuar Qendra, aktivitetet dhe shërbimet që do të ofrohen në qendër.

3.9. Paketa e Advokimit të të mbijetuarve për përmirësimin e përgjigjes së drejtësisë penale ndaj viktimave të reja të dhunës seksuale në Shqipëri

Paketa e advokimit të të mbijetuarve është një set veprimesh që organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" ka testuar nëpërmjet iniciativave të mëparshme për të sjellë zërin dhe prespektivat e të mbijetuarve në sistemin e drejtësisë penale dhe për të aktivizuar burime për mbështetjen e viktimave. Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" ka sjellë pjesëmarrjen e të mbijetuarve në një nivel më të lartë, në bashkëpunim me avokatin e popullit dhe Panelin keshillimor të të Mbijetuarve. Paketa e advokimit do të zgjerojë punën e Panelit e të të mbijetuarve dhe do të fuqizojë pozicionin e tij në mesin e kontribuesve të drejtësisë penale.

3.10. Fuqizimi i stafit që punon me viktimat e trafikimit për të parandaluar traumën sekondare dhe konsumimin profesional

Organizata “Të Ndryshëm dhe Të Barabartë”, filloi zbatimin e projektit “Fuqizimi i stafit i cili punon me viktimat e trafikimit për të parandaluar traumën sekondare dhe konsumimin profesional” financuar nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë, për një periudhë 12 mujore, në Shtator 2023, projekt i cili përfundon në Gusht 2024.

Ky projekt synon të mbështesë strehëzat për t'u përballur me sfidat e punës me viktimat e trafikimit dhe për të përballuar traumat sekondare si rezultat i punës së përditshme me personat e traumatizuar. Aktivitetet e projektit do të përqendrohen në seminare, trajnime, supervizime, shkëmbim përvojash dhe përgatitjen dhe publikimin e një udhëzuesi për të ndihmuar stafin për t'i kapërcyer këto sfida.

Aktivitetet gjatë zbatimit të projektit përfshijnë:

1. Përgatitja e një Udhëzuesi për parandalimin e traumave sekondare dhe konsumimin profesional për profesionistët
2. Organizimi i 2 workshop-eve për parandalimin e traumave sekondare dhe konsumimin profesional
3. Organizimi i seancave të supervizimit për stafin e KKSAT
4. Organizimi i 2 shkëmbimeve të përvojave ndërmjet stafëve të qendrave të KKSAT
5. Organizimi i 2 trajnimeve për trajtimin e rasteve të vështira dhe çështjeve në Strehëza

1. Përgatitja e një Udhëzuesi për parandalimin e traumave sekondare dhe konsumimin profesional për profesionistët

Ky udhëzues ofron informacion praktik për profesionistët që punojnë me viktimat e trafikimit për të parandaluar traumat sekondare dhe konsumimin profesional për profesionistët. Udhëzuesi eksploron natyrën e sfidave dhe shkaqet e tyre, por gjithashtu ofron strategji dhe burime për profesionistët e fushës për të ruajtur mirëqenien e tyre ndërsa ndjekin me pasion punën e tyre të vlefshme.

Në përgatitjen e udhëzuesit, eksperti i kontraktuar është bazuar kryesisht në takimet e supervizimit të zhvilluara me një pjesë të madhe profesionistësh që punojnë me viktimat e trafikimit nga disa organizata. Gjithashtu, janë organizuar disa fokus grupe për të kuptuar më mirë përmbushjen e nevojave dhe specifikat e strategjive mbështetëse. Materiali ofron ushtrime dhe aktivitete vetëeksploruese, eksperimentale, gjithëpërfshirëse, ndërvepruese dhe praktike. Është i pasuruar edhe me raste konkrete përmes rasteve nga përvoja në terren, lidhjet, instrumentet, vetëvlerësimi dhe mjetet terapeutike.

Përmbajtja e udhëzuesit:

- I. Hyrje A. Vështrim i përgjithshëm i traumës sekondare B. Rëndësia e trajtimit të traumës sekondare C. Audiencia e synuar
- II. Kuptimi i traumës sekondare A. Përshkrimi i traumës sekondare B. Konceptet dhe terminologjia kryesore C. Shpërndarja te profesionistët që punojnë me viktimat e abuzimit seksual D. Shenjat dhe simptomat
- III. Faktorët e rrezikut A. Faktorët Personal B. Faktorët e Punës C. Mekanizmat dhe Strategjitë Ndhmuese
- IV. Ndikimi tek profesionistët A. Ndikimi emocional dhe psikologjik B. Pasojat për shëndetin fizik C. Ndikimi në marrëdhëniet dhe jetën personale D. Ndikimi në performancën e punës
- V. Parandalimi dhe kujdesi personal A. Roli i kujdesit personal në reduktimin e traumës sekondare B. Ndërtimi i reziliencës C. Vendosja e kufijve D. Njohja e nevojës për ndihmë
- VI. Mbështetja organizative A. Roli i punëdhënësit ose organizatës B. Supervizimi dhe mbështetja nga bashkëpunëtorët C. Krijimi i një mjedisi mbështetës të punës
- VII. Strategjitë dhe burimet e përballimit A. Teknikat e relaksimit dhe reduktimit të stresit B. Grupet mbështetëse dhe rrjetet profesionale C. Këshillimi dhe terapia D. Qasja në burimet e komunitetit
- VIII. Raste studimore dhe skenarë praktikë A. Raste studimore në jetën reale B. Diskutim dhe analizë C. Strategji për trajtimin e traumës sekondare në raste specifike
- IX. Konkluzioni A. Rishikimi i mesazheve kryesore B. Inkurajimi për vetë-kujdes dhe kërkimin e mbështetjes C. Mësimi për të trajtuar traumën dytësore në terren
- X. Burime shtesë A. Libra, artikuj dhe kërkime B. Faqet e internetit dhe komunitetet e mbështetjes në internet C. Informacioni i kontaktit për linjat e ndihmës dhe shërbimet e krizave

2. Organizimi i seancave të mbikëqyrjes për stafin e Koalicionit Kombëtar të Strehimoreve Antitrafik

“Të ndryshëm & të barabartë” ka kontraktuar Ekspertin, një psikoterapist profesionist për ofrimin e seancave individuale të supervizimit me stafin e qendrave të KKSAT. Profesionistëve, staf të katër qendrave u janë ofruar seanca individuale të supervizimit.

4 Koordinimi dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë në fushën antitrafikim

D&E ka vijuar bashkëpunimin dhe koordinimin me të gjitha Insitucionet, agjencitë dhe OJF-të aktive në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe në veçanti për mbrotjen e viktimave të trafikimit. Gjatë kësaj periudhe D&E ka ndjekur disa aktivitete (trajtime, konferenca, tryeza, seminare, sesione informimi). Gjithashtu edhe në aktivitetet e zhvilluara nga D&E është synuar që të ketë një pjesëmarrje gjithpërfshirëse duke i konsideruar aktivitetet si një instrument shumë i mirë për të konsoliduar rrjetin e bashkëpunëtorëve dhe për të përmirësuar ndërveprimin midis tyre në funksionon të një përgjigje të koordinuar sa më mirë.

D&E ka marrë pjesë në takimet e organizuar për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit e organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti -Trafik dhe me pjesëmarrjen e anetareve të MKR. Pas rishikimit nga të gjitha institucionet anëtare, mëdatë 13.10.2023 u firmos MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT për FUNKSIONIMIN E MEKANIZMIT KOMBËTAR TË REFERIMIT PËR VIKTIMAT DHE VIKTIMAT E MUNDSHME TË TRAFIKIMIT TË PERSONAVE. Kjo Marrëveshje ka për objekt rregullimin e funksionimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave.

- D&E ka marrë pjesë në takimet e organizuar nga Autoriteti Përgjegjës.
- D&E ka marrë pjesë në takimet e Komitetit Rajonal Antitrafik të organizuara nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

5 Pjesëmarrja e stafit në trajnime


Data	Trajnimi
24 Janar	“Komunikimi strategjik online” organizuar nga Arise Foundation, trajnim për rritje kapacitetesh
9 - 10 Shkurt	“Mbi Psikodramën, Yoga dhe meditim, teknika reflektimi” Aktivitet në kuadër të projektit të supervizimit për stafet në linjë direkte me rastet e trafikimit dhe dhunës
23 - 24 Shkurt	“Peer to peer supervision” Aktivitet në kuadër të projektit të supervizimit për stafet në linjë direkte me rastet e trafikimit dhe dhunës
1 Qershor	“Nevoja për hartimin e një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit në Shqipëri”, Tiranë. Organizuar Arise Foundation
Korrik	“Përkujdesi i Informuar mbi Traumën”, trajnim online me module nga Alo Mik
Shtator	“Procesi i menaxhimit të rastit për të mbijetuarit e trafikimit të qënieve njerëzore në Shqipëri”
12 Shtator	“Traumat dytësore dhe lodhja e dhembshurisë” Aktivitet në kuadër të projektit të supervizimit për stafet në linjë direkte me rastet e trafikimit dhe dhunës
27 - 28 Shtator	“YOGA dhe MEDITIM” Retreat / Trajnim në Valbonë
Tetor	Mental Health Psychosocial support për fëmijë dhe ofrues shërbimesh, ku stafi i D&E ka marrë pjesë dhe është certifikuar për këtë trajnim
5- 6 Tetor	HIV dhe Semundjeve Seksualisht të Transmetueshme (SST) -Streha LGBT

19 Tetor	“Forcimi i kapaciteteve të organizatave anëtare të Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore për përgatitjen e raporteve hije dhe alternative për mekanizmat ndërkombëtarë, mbi të drejtat e njeriut në fushën e dhunës me bazë gjinore” online, organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në bashkëpunim me UN Women Albania
31 Tetor	“Zbatimi i Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë”, tryezë e rrumbullakët nga Shoqata “Gender, Paqe e Siguri”
23 - 24 Nëntor	“Ankimi Kushtetues Individual”, Tiranë. Organizuar nga UNDP dhe ADC
11 - 14 Dhjetor	“Seancë e simuluar gjyqësore për rastet e trafikimit në persona”, Ohër, Maqedoni. Organizuar nga UNODC në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës në Shqipëri

6 Manuale, Udhëzues dhe materiale të tjera - Botime

Dokument tematik “Riintegrimi i të mbijetuarave nga dhuna me bazë gjinore”

Ky dokument është përgatitur nga organizata “Të Nryshëm & Të Barabartë” në kuadër të projektit “Ofrimi i programeve të riintegritit ekonomik për të paktën 80 gra në bashkitë e Kukësit, Dibrës, Korçës dhe Beratit, përfshirë edhe gratë e grupeve vulnerabël”, me mbështetjen e UN Women në kuadër të programit “Fund dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi Faza II”, financuar nga Bashkimi Europian.



Doracaku “Praktikat e mira të riintegritit të të kthyerve viktimat të dhunës me bazë gjinore”

Ky document është përgatitur nga organizata “Të Nryshëm & Të Barabartë” në kuadër të projektit “Programi i Riintegritit për Migrantët e Kthyer në Shqipëri”, financuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).

Libërth me ushtrime dhe teknika për çlirim e stresit

Libërthi me ushtrimet synon nxitjen e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të vajzave viktimat/viktima të mundshme të trafikimit, viktimat të abuzimit seksual dhe dhunës në familje. Ky botim u realizua me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, AKR dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, MSHRF.



